



Fuqia e të barabartëve në luftën kundër dhunës me bazë gjinore

TRAJNIM / TIRANË, SHQIPËRI

Dhuna me bazë gjinore është një nga format më të përhapura të abuzimit të të drejtave të njeriut, e cila çon drejtpërdrejt në shkelje të dinjitetit njerëzor kudo në Botë. Ngjarjet e tanishme në Shqipëri dhe më gjerë raportojnë dhe tregojnë një nevojë urgjente në mbështetje të të rinjëve të cilët në shumë raste gjenden në rolin e viktimës apo edhe të dhunuesit. Përqëndrimi tek profesionistët e rinj, trajnimi i vazhdueshëm i tyre dhe krijimi i një mjedisi kreativ dhe bashkëpunues siguron angazhimin e potencialit të pazëvendësueshëm që zhvillohet mes të rinjëve për të rinjtë.

DEV-AID do të zhvillojë një trajnim 5 ditor në datat 23 – 27 TETOR në çështjet gjinore për të rinjtë, punonjës social, psikologë shkollash, aktivistë gjinorë, vullnetarë etj. 20- 25 të rinj do të pajisen me njohuritë e duhura, të kuptojnë dhe monitorojnë çështjet gjinore në mjedisin e punës, mjediset formale apo jo- formale arsimore. Aftësi të reja trajnuese do tu mundësojë pjesëmarrësve të ofrojnë shërbim cilësor me grupet që ata punojnë dhe të ndajnë aftësitë e reja dhe eskperienat e tyre me bashkëmohatarët. Metodologjia e trajnimit do të jetë të mësuarit mes të barabartëve (Peer education) duke përdorur një nga manualët praktik të Këshillit të Europës (Gender Matters).

Çfarë do të ndodh?

DITA 1 - 2P / PEER to PEER

Programi i ditës së parë do të përqëndrohet në rolin dhe ndikimin e fuqishëm mes bashkëmohatarëve në mënyrën se si ata sillen, mendojnë dhe ndajnë informacionin mes njëri-tjetri, sidomos rreth çështjeve të ndjeshme dhe relativisht të munguara gjatë edukimit formal. Ne do të përdorim edukimin mes të barabartëve si një mënyrë për të fuqizuar profesionistët e rinj si agjent të ndryshimit.

DITA 2 – NDRIÇO IDENTITETIN TIM GJINOR

Gjatë ditës së dytë të trajnimit pjesëmarrësit do të inkurajohen të eksplorojnë besimet lidhur me përkatësinë gjinore, besime të ndërtuara në kohë gjatë ndërveprimit social dhe familjar. Gradualisht, nisur nga prespektiva vetjake, të rinjtë do të eksplorojnë se si këto perceptime plotësojnë realitetin e tyre dhe anasjelltas. Pjesëmarrësit do të mësojnë të vlerësojnë në mënyrë kritike ndikimin e normave të ngurta gjinore, pabarazisë dhe abuzimit.





DITA 3 – GJINIA SI LENTE

Në ditët e sotme është shumëdimensional ndikimi që media masive dhe media sociale kanë në jetën tonë të përditshme. Edhe pse e para krahasuar me të dytën e vendos audiencën në një pozitë pasive, së bashku ndikojnë në opinionin publik. Gjatë ditës së tretë pjesëmarrësi do të angazhohet në aktivitete të ndryshme që lidhen me rolin që luan media në promovimin e barazisë gjinore dhe në përfaqësimin e grave dhe burrave, në aspektin e një portretizimi të drejtë gjinor. Analizimi dhe krahasimi do të ndihmojnë pjesëmarrësit të jenë më vigjilentë, kritikë dhe të aftë për të identifikuar ose adresuar pabarazitë dhe boshllëqet që krijon pabarazia gjinore. Media luan një rol të rëndësishëm në promovimin e historisë, nxitjen e institucioneve publike dhe private, të përditshmërisë dhe mbrojtjen e identitetit tonë.

DITA 4 – FOTOGRAFIMI I DHUNËS ME BAZË GJINORE

Është e rëndësishme të mendojmë në mënyrë kritike mbi rolin gjinor në prodhimin dhe konsumimin e tregimeve, imazheve, fjalëve dhe karaktereve. Kjo do të ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë më mirë botën rreth tyre, komunitetin, grupin shoqëror, procesin e edukimit dhe rolin e familjes. Angazhimi në realizimin e fotografive do t'i ndihmojë ata të analizojnë, të përpilojnë dhe të kuptojnë pozicionin e tyre në luftën ndaj dhunës me bazë gjinore.

DITA 5 – EKSPOZITA E FOTOGRAFIVE

Trajnimi do të mbyllet me ekspozitën e fotografive realizuar nga vetë pjesëmarrësit.



Rezultatet:

- ✓ Themelimi i një rrjeti lokal të profesionistëve që punojnë me dhunën më bazë gjinore tek të rinjtë.
- ✓ 20- 25 profesionistë do të zhvillojnë kapacitetet e tyre bazuar në aktivitete jo- formale.
- ✓ 20- 25 profesionistë do të pajisen me mjetet e duhura në mënyrë që të replikojnë njohuritë e fituara në mjedisin e punës.
- ✓ Rreth 100 të rinj do të marrin pjesë gjatë sesioneve/ workshop-eve. (Follow- up)
- ✓ Promovimi i punës artistike të pjesëmarrësve në median sociale.
- ✓ Numri i raportimeve nga të rinjtë i dhunës me bazë gjinore do të jetë në rritje.

SHËNIM: Trajnimi do të mbahet në gjuhën shqipe dhe është i hapur për të gjithë të interesuarit.

Afati i fundit i aplikimit është data **6** Tetor 2017

APLIKO TANI!